

INDEKSI I SHITJEVE NETO NË SHËRBIME

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes	6
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia	7
13. Saktësia dhe besueshmëria	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave Afatshkurtra
1.3. Personi i kontaktit	Eris Alikaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Statistikave Afatshkurtra
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	elialikaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	13.03.2020
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	15.03.2019
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	13.03.2020
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Indeksi i Shitjeve Neto është një tregues tremujor afatshkurtër i përdorur për analizën e ciklit të biznesit. Burimi kryesor për Indeksin e Shitjeve Neto në Shëbime është Vrojtimi Tremujor i Statistikave Afatshkurtra (Moduli 126, 1261 127, 128, 129, 1231, 1232).
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi statistikor i aktiviteteve ekonomike bazohet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike NVE Rev.2 .
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi për këtë indikator përfshin ndërmarrjet e klasifikuaranga seksioni G tek N të NVE Rev.2. G - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 45

	<p>G – Tregtia me shumicë mbulohen aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 46</p> <p>H - Transporti dhe magazinimi mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodet 49 deri 53</p> <ul style="list-style-type: none"> • Transporti hekurudhor mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 49 • Transporti detar mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 50 • Transporti ajror mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 51 • Magazinimi dhe aktivitetet mbështetëse për transportin mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 52 • Aktivitete të postës dhe korrierës mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 53 <p>I - Hoteli mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 55.00</p> <p>- Bar, Restorant mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 56.00</p> <p>J - Informacioni dhe komunikimi mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kode 58, 61, 62</p> <ul style="list-style-type: none"> • Aktivitetet e botimit mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 58 • Telekomunikacioni mbulon aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 61 • Shërbime të teknologjisë së informacionit mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 62 <p>M - Aktivitetet arkitektonike dhe inxhinierike mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 71</p> <p>N - Agjensitë e Udhëtimit mbulojnë aktivitetet ekonomike të listuara në kodin 79.</p> <p>Vrojtimi përfshin të gjitha ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, si dhe një numër përfaqësues të ndërmarrjeve të vogla. Një shtresë përcaktohet sipas klasave dhe bazohet në numrin e të punësuarve.</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Objektivi i indeksit të shitjeve neto është të tregojë zhvillimin e tregut të mallrave dhe të shërbimeve. Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo koresponдон me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve ndaj palëve të treta. Gjithashtu përfshin të gjitha tarifat e tjera (transporti, paketimi, etj.) të kaluara tek klienti, edhe nëse këto tarifa janë renditur veçmas në faturë. Shitjet neto përjashtojnë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksat e tjera të ngjashme të zbritshme të lidhura drejtpërdrejt me shitjet neto si dhe të gjitha detyrimet dhe taksat për mallrat ose shërbimet e faturuara nga njësia. Indekset e shitjeve neto të brendshëm dhe të eksportit kërkojnë që shitjet të ndahen sipas destinacionit të parë të produktit bazuar në ndryshimin e pronësisë. Destinacioni përcaktohet nga vendi rezident i palës së tretë që ka blerë mallrat dhe shërbimet. Të dhënat në lidhje me indeksin e shitjeve neto të brendshëm dhe atë të eksportit janë mbledhur, por nuk publikohen.</p>
<p>3.5. Njësia statistikore</p>	<p>Njësia e vrojtuar është ndërmarrja.</p>

3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore përfshin njësitë statistikore, ndërmarrje, të cilat operojnë në aktivitete ekonomike sipas NVE Rev. 2, Shërbime (seksioni H, ndarjet 49-53; seksioni I, ndarja 55.1 dhe 56.00; seksioni J, ndarjet 58-63; seksioni M, ndarja 71; seksioni N, ndarja 79). Ndërmarrjet me 1-9 të punësuar janë vrojtuar me kampion, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë vrojtuar tërësisht.
3.7. Zona e referencës	Indeksi i shitjeve neto në shërbime mbulon gjithë territorin e Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	Vrojtimi tremujor i Statistikave Afatshkurtra referuar Indeksit të shitjeve neto në shërbime datojnë prej vitit 2005 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Viti bazë 2015=100, aplikohet duke filluar nga tremujori i parë 2019.
4. Njësia matëse	Njësitë matëse janë Indekset dhe Ndryshimet në përqindje (%).
5. Periudha e referencës	Informacioni i grumbulluar dhe përpunuar i referohet periudhave tremujore. Ky raport i përket vitit referencë 2019.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore në të cilin bazohen indikatorët e statistikave afatshkurtra konsiston në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021 <p>Klasifikimet dhe Përkufizimet sipas rregulloreve përkatëse të BE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregullorja e Këshillit Nr.1165 / 98 duke prezantuar Statistikat afatshkurtra në nivel Evropian • Rregullorja e Komisionit Nr.1503 / 2006 e cila përcakton variablat dhe shpeshësinë e përpilimit të të dhënave, shfuqizimi i porosive të reja të marra për ndërtimin e ndërtesave dhe urdhërat e reja të marra për inxhinierinë civile.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Shkëmbimi i të dhënave për Statistikat Afatshkurtra ka filluar në tremujorin e tretë 2017 në nivelin Evropian. Nga tremujori i parë i vitit 2018 të dhënat për Indeks të Shitjeve Netë në Shërbime transmetohen rregullisht në Eurostat.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 PËR STATISTIKAT ZYRTARE, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit.

	<p>Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
<p>7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave</p>	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijojnë paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësi statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktuara shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomanduara se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p>
<p>8. Politika e botimit</p>	
<p>8.1. Kalendarin e publikimeve</p>	<p>Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
<p>8.2. Aksesin në kalendarin e publikimeve</p>	<p>Kalendarin e publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p>8.3. Aksesin i përdoruesve</p>	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi;

	4. Kërkesa për të dhëna , seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Indeksi i Shitjeve Neto në Shërbime shpërndahet me bazë tremujore.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, çdo tremujor publikohet njoftim për media mbi Statistikat Afat-Shkurtra. Formatit i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave Afatshkurtra publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT nën nëntemën: Statistikat Afat-Shkurtra .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e Statistikave Afatshkurtra. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: Databaza Statistikore
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e Statistikave Afatshkurtra nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 31, pika 7 ligji nr. 17/2018, datë 17.04.2018 "Për statistikatat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Afatshkurtra dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ATN për qëllime të brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuar. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit

	të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Është bërë një krahasim me të dhënat e vitit të kaluar për të parë nëse ka ndonjë koherencë të të dhënave apo nëse ka pasur ndryshime të mëdha. Në rast ndryshimesh, të dhënat administrative përdoren për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen ndryshime të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdorues janë klasifikuar në të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p>Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministrinë dhe administrata publike që përdorin të dhënat për qëllime të planifikimit të politikave ekonomike dhe sociale. • Universitetet (profesorë / studentë të diplomuar dhe pasuniversitar), organizata kërkimore. • OJQ Kombëtare dhe Ndërkombëtare • Ndërmarrjet • Publiku i gjerë që merr informacionin përmes mediave masive përmes publikimeve të bëra nga Zyra e Statistikave. <p>Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Llogarive Kombëtare • Sektori i Regjistrat Statistikor të Ndërmarrjeve • Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikime (Page Views) në lidhje me Statistikat Afatshkurtra për vitin 2019 janë rreth 6,132 klikime.</p> <p>Gjatë 2019 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave Afat-Shkurtra është vlerësuar me 3.62 (72.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	Për sa i përket plotshmërisë së Statistikave Afatshkurtra, ato ndërtohen në përputhje me rregulloret e Eurostat. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave për vrojtimin e Statistikave Afatshkurtra për vitin 2019 është 70.6%. Kjo llogaritje mori parasysh rregulloren evropiane. Si rezultat, llogaritja e Indeksit të Shitjeve Neto në Shërbime dhe të dhënat e siguruara janë në përputhje me Rregulloret përkatëse të BE-së.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të

13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënat e anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion.</p> <p>Popullata e vëzhguar e Statistikave Afat-Shkurtra 2019 përfshin afërsisht 9000 ndërmarrje për çdo tremujor nga të cilat afërsisht 2463 ndërmarrje përfshihen në aktivitetet e Shërbimeve. Dizanji kampionimit është kampionim i thjeshtë i rastësishëm, i shtresëzuar. Kriteri i përdorur për shtresëzim është numri i punonjësve sipas NVE Rev.2 në nivel 3 shifror.</p> <p>Llogaritja e vlerësimeve të të dhënave statistikore dhe analiza e njësive outlier kryhet rregullisht. Shkalla e saktësisë së përgjithshme është e lartë, duke marrë parasysh shkallën e lartë të përgjigjes. Për të llogaritur vlerësimet, përdoret vlerësuesi Horvitz-Thompson, që është i paanshëm. Saktësia e vlerësimeve arrihet duke eliminuar gabimet e kampionimit dhe të jo kampionimit, të tilla si mbulimi, pa përgjigje, gabimet e përgjigjes dhe gabimet e përpunimit.</p> <p>Arsyet e shfaqes së gabimeve në mbulim janë keq klasifikimi i njësive dhe ndryshimet në statusin e njësive raportuese. Është e detyrueshme t'i përgjigjesh vrojtimit. Në rast mos-përgjigje, njësitë kontaktohen përmes telefonit dhe postës elektronike. Gabimi në kampionim në përqindje (CV) llogaritet për treguesit kryesorë të vrojtimit që publikohen çdo tremujor.</p>						
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet e kampionimit trajtohen në raportet e brendshme teknike, ku për çdo indikator në vrojtimit llogaritet varianca e totalit, si dhe gabimi standart relativ, për eliminimin e efektit negativ që jep lëvizja e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjes në serinë kohore të vlerave. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.</p>						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel rekordi mesatarisht për ATN 2019 është 3.71%.</p>						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet për Indeksin e Shitjeve Neto në Shërbime janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 73 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 73 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Indeksi i Shitjeve Neto në Shërbime është 31 Dhjetori 2019.</p> <table border="1" data-bbox="432 1715 855 1839"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2019</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>3/13/2020</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>73</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2019	Data e publikimit	3/13/2020	Afatet kohore	73
Periudha referuese	12/31/2019						
Data e publikimit	3/13/2020						
Afatet kohore	73						
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat për Indeksin e Shitjeve Neto në Shërbime, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Indeksit të Shitjeve Neto në Shërbime ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p>						

	Periudha referuese	12/31/2019
	Data e shpallur	3/13/2020
	Data e publikimit	3/13/2020
	Vonesa në kohë	0

15. Koherenca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat për Indeksin e Shitjeve Neto në Shërbime janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivel vendi.
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Ndër vite Indeksi i Shitjeve Neto në Shërbime ka pësuar ndryshime në fushën e mbulimit dhe në metodën e zgjedhjes. Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve ka filluar për herë të parë në vitin 2005. Ndërmarrjet më 1-9 të punësuar janë me kampionim, ndërsa ndërmarrjet me mbi 10 të punësuar janë marrë me listim (në mënyrë ekzostive) pa ndryshuar fushën e mbulimit. Në vitin 2012 ndryshon popullsia si rezultat i përditësimit të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve me rezultatet e Rregjistrimit të Ndërmarrjeve Ekonomike, 2010. Të gjitha ndryshimet janë raportuar në shpjegimet metodologjike që shoqërojnë publikimet përkatëse. Në vitin 2014 në Indeksin e Shitjeve Neto në Shërbime u implementua nomenklatura e aktiviteteve ekonomike, NVE Rev. 2, struktura e peshave që është azhornuar dhe ndryshimi i periudhës bazë të indekseve nga 2005 në 2010.</p> <p>Në vitin 2019 në SASH përditësohet struktura e peshave dhe ndryshon periudha bazë e indekseve nga 2010 në 2015. Të gjitha këto ndryshime në serinë e indekseve nuk janë shkëputur, por indekset janë kthyer mbrapa në kohë. Këto ndryshime janë raportuar në shpjegimet metodologjike që bashkohen me botimet përkatëse.</p>
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Të dhënat kontrollohen me burimet administrative me bazë tremujore. Pas këtyre kontrolleve mund të konkludohet se të dhënat janë koherente.
15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar përpara se ato të finalizohen. Lidhja midis variablave është kontrolluar dhe koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave është konfirmuar. Specialistët e Statistikave afatshkurtra punojnë së bashku me specialistë të drejtorive përkatëse për të siguruar qëndrueshmërinë dhe koherencën të treguesve statistikor.
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Kostoja e Statistikave Afatshkurtra përfshin informacion mbi numrin e stafit të përhershëm dhe të përkohshëm. Numri i stafit të ATN është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Totali i stafit në Zyrën Qendrore: 1 punonjës • Specialistët e logjistikës 1 të punësuar • Kontrollorë (4 muaj) 2 të punësuar • Operatorë (4 muaj) 2 të punësuar <p>Për trajtimin e mos përgjigjes përdoren të dhënat administrative për imputim të cilat janë falas. Marrëveshja e bashkëpunimit është nënshkruar midis INSTAT, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Qendrës Kombëtare të</p>

	<p>Biznesit (QKB), në mënyrë që transmetimi i të dhënave administrative të mundësohet pa kosto. Burimet Statistike si (Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ATN e mëparshme) janë gjithashtu pa kosto, pasi janë konsideruar si përdorues të brëndshëm. Stafi i ATN menaxhon kontrollin dhe analizën e të dhënave, kështu që edhe këto dy procese nuk kanë kosto të tjera shtesë.</p>
<p>17. Rishikimi i të dhënave</p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Të dhënat e publikuara nuk konsiderohen përfundimtare ato mund të rishikohen. Të dhënat mund të rishikohen për një sërë arsyesh si: implementimi i klasifikimit të ri NVE, ndryshime metodologjike, burime të reja informacioni ose të përmirësimeve të të dhënave dhe korrigjime të gabimeve. Rishikimi i tremujorit paraardhës është i mundur të kryhet gjatë çdo tremujori dhe në fund të çdo viti mund të kryhen korrigjime për të katërt tremujorët.</p>
<p>18. Përpunimi statistikor</p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Të dhënat bazohen në anketat statistikore tremujore. Baza e përzgjedhjes është Regjistri i ndërmarrjeve aktive për vitin referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NACE Rev. 2. Popullata në studim përcaktohet nga dy kritere themelore: Madhësia e ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve) dhe aktiviteti ekonomik brenda fushës së studimit, me prerje. Metoda e përzgjedhjes së përdorur është Përzgjedhje e thjeshtë e Rastit me Shtresëzim (SRS). Shtresëzimi bazohet në kombinimin e aktivitetit ekonomik me grupin e madhësisë së ndërmarrjes. Treguesit janë paraqitur për aktivitete ekonomike sipas fushave të përcaktuara në rregulloren e Statistikave Afat-Shkurtra dhe gjithashtu bazuar në nevojat e përdoruesve.</p>
<p>18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Të dhënat mblidhen çdo tremujor.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Të dhënat grumbullohen me intervistim të drejtpërdrejtë me pyetësor me letër çdo tremujor, 15 ditë pas mbylljes së tremujorit referues. Kohëzgjatja në terren është 15 ditë pune.</p>
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Të dhënat e marra nga vrojtimi dhe nga skedari i TVSH-së (i përdorur për imputim) vlerësohen duke përdorur rregulla logjike të vlefshme.</p> <p>Në nivel kombëtar, editimi përfshin studimin e të dhënave të të anketuarve me qëllim identifikimin (dhe korrigjimin) e gabimeve. Jo të gjitha gabimet mund të identifikohen, por qëllimi është të zbulohen ato gabime që kanë ndikim të madh tek rezultatet.</p>

	<p>Rregullat për identifikimin e gabimeve mund të vënë në dukje gabime të mundshme të cilat kërkojnë një studim të mëtejshëm për të kuptuar se ku qëndron gabimi përkundrejt një rezultati të pazakontë ose mund të evidentojnë gabime të përcaktuara. Redaktimi (editimi) përfshin kontrolle për tërësinë, që vlerat janë brenda kufijve të caktuar dhe se vlerat për variablat e lidhur janë koherent. Redaktimi i të dhënave mund të bëhet gjatë ose pas hedhjes së të dhënave.</p> <p>Përgjigjet mund të krahasohen me përgjigjen e tremujorëve të mëparshëm. Mospërputhja ose devijimet e mëdha (jashtë një diapazoni të paracaktuar) tregojnë se një studim më i thellë do ishte i rëndësishëm. Kjo mund të rezultojë në redaktim të dhënash. Në kontekstin e afatit kohor, procesi i redaktimit mund të jetë i dizajnuar për t'i dhënë përparësi kryesore atyre njesi outlier që kanë më shumë nevojë për redaktim për hir të agregateve të besueshëm. Me zgjidhjen e rasteve më të këqija, mund të arrihen përmirësime të mëdha.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Nivel Kombëtar</p> <p>Hapi i parë është mbledhja e informacionit direkt i mbledhur nga anketuesit. Qëllimi është për të sjellë këtë informacion në nivelin statistikor. Proçesi i ndjekur është si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli fizik i pyetsorëve (verifikimi i plotësimit të pyetsorëve sipas standarteve të skanimit) • Kontrolli logjik i pyetsorëve (kontrolli i shënimit logjik të indikatorëve të përgjigjes, përshkrimi të aktivitetit dhe kodifikimit si dhe kontrolli i plotësimit të shifrave) • Pas hedhjes së të dhënave, gabimet dhe mospërputhjet evidentohen dhe korrigjohen përgjatë redaktimit (editimit). • Mos-përgjigjet dhe mungesa e informacionit për ndërmarrjet e rëndësishme (ndërmarrjet e mëdha) duhet të plotësohen nëpërmjet proçesit të imputimit duke përdorur informacionin e marrë nga burime të tjera. • Krahasueshmëria e të dhënave (ndërmjet të dhënave të vrojtimit dhe të dhënave administrative, periudhat e mëparshme ose trendet). • Analiza e rezultateve për çdo fushë publikimi (domein). • Rezultatet e plota dhe të pastra të të dhënave shërbejnë më pas për fazën e peshimit dhe ri-peshimit • Të dhënat e agreguara krahasohen me të dhëna nga burime të tjera • Dy fazat e fundit mund të jenë subjekt analizash të tjera, në funksion të rezultateve sipas fushave të publikimit (domein-et). <p>Së fundi, kur analiza statistikore ka përfunduar, këto të dhëna përcaktohen si grup informacioni jo-publike. Para shpërndarjes së rezultateve, fazë shumë e rëndësishme është ruajtja e konfidencialitetit të këtij informacioni.</p>
<p>18.6. Rregullimi</p>	<p>Indeksi i Shitjeve Neto në Shërbime llogaritet i përshtatur sezonalisht dhe i papërshtatur sezonalisht.</p> <p>Përshtatja sezonale e serive kohore tremujore të Statistikave Afatshkurtra u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.1.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2005 - Tremujori IV 2019. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është</p>

	zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative) dhe qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.
19. Komete	
Aneks	